

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Letërnjoftimi i Komunës së Deçanit 2012

Shtator 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Problemet në komunën e Deçanit.....	5
2. Performanca buxhetore e komunës së Deçanit.....	7
3. Investimet kapitale.....	9
4. Aktivitetet e prokurimit publik 2010 - 2011 .....	10
5. Administrata e komunës së Deçanit .....	11
6. Arsimi në komunën e Deçanit.....	12
7. Shëndetësia në komunën e Deçanit.....	14
8. Transparenca .....	15
9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	18
10. Burimet: .....	22

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Deçanit qeveriset nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ky subjekt politik e udhëheq këtë komunë nga viti 2002 kur janë zhvilluar zgjedhjet e dyta për kuvendin komunal. Në atë kohë qeverisja e Komunës së Deçanit kaloi nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) tek AAK. Kryetari aktual i Komunës së Deçanit, z. Rasim Selmanaj, është zgjedhur në krye të komunës në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2009. Ai mori shumicën absolute të votave ndaj kundër kandidatëve të tij duke u zgjedhur kështu kryetar komune pa balotazh.

AAK ka shumicën absolute edhe në Kuvendin e Komunës së Deçanit. Nga gjithsejtë 27 ulëse sa numëron kuvendi komunal i Deçanit, 16 janë me anëtarë të AAK-së, 5 të LDK-së, 2 të PDK-së, 2 të LDD-së, dhe nga 1 AKR e PSD.

Shkalla e të hyrave komunale në Deçan ka qenë e ndryshme nga viti në vit, duke mos treguar rritje lineare, por duke pasur edhe ulje të të hyrave. Në vitin 2011 shkalla e të hyrave komunale ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Sipas Auditorit të Përgjithshëm, komuna e Deçanit nuk mban një regjistër të plotë të të hyrave komunale, dhe nuk e ka të precizuar listën e bizneseve aktive dhe jo aktive. Ky faktor ndikon në shkallën e të hyrave komunale, ngase disa biznese mund të mos tatimohen, ndërsa disa të tjera edhe përkundër shuarjes së veprimtarisë, mund të ngarkohen me tatime.<sup>1</sup>

Komuna e Deçanit bën pjesë në mesin e komunave ku në linjën e mallrave dhe shërbimeve janë hasur shifra të konsiderueshme të shpenzimit të parasë publike për darka dhe dreka zyrtare, për udhëtime zyrtare, telefon, mëditje, derivate, reprezentacion dhe shpenzime të tjera.

Kjo komunë në dy vitet e fundit është karakterizuar edhe me nivel të konsiderueshëm të borxhit publik, përkatësisht faturave të papaguara. Në vitin 2011, shuma e përgjithshme e faturave të papaguara nga kjo komunë ka qenë 377.238 euro, një vit më herët shkalla e borxhit ka qenë 202.238 euro, kurse më 2009 ka qenë 78.398 euro. Kjo tregon se komuna ka kontraktuar punë pa mbulesë financiare. Borxhi i madh publik i komunës vë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të këtij institucioni. Sipas Auditorit të Përgjithshëm, organizata duhet të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime të furnizuara duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.”<sup>2</sup> Auditori ka vërejtur se komuna e Deçanit ka prezantuar faturat e papaguara lidhur me mallrat dhe shërbimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2011 me shumë mbi 360 mijë euro. Sipas Ligjit

---

<sup>1</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011.

Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Decan\\_2011\\_ALB\\_434669.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Decan_2011_ALB_434669.pdf)

<sup>2</sup> Po aty.

nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë “organizata buxhetore nuk lejohet të hyjë në detyrime gjatë vitit aktual fiskal më shumë që tejkalon fondet e përvetësuara.” Auditori ka vërejtur se Komuna e Deçanit ka raportuar obligime (fatura të papaguara) me shumë të lartcekur të cilat kanë rezultuar jashtë kapaciteteve buxhetore të komunës.<sup>3</sup>

Nga lista e borxheve që ka komuna e Deçanit, rezulton se mbi 95% të tyre i ka për derivate veturash, riparim veturash dhe për material për zyre, ndërsa pjesa tjetër janë fatura të papaguara ndaj ujësjellësit, KEK-ut dhe medieve për publikime dhe shpallje.

Autoritetet lokale do të duhet të ndërmerrnin masa shumë më serioze në pamundësimin e rasteve të konfliktit të interesit. Ka të dhëna të cilat dëshmojnë lidhje të ngushta mes udhëheqësve të komunës dhe personave që përfaqësojnë firma private të cilat në shumicën e rasteve janë përfitues të tenderëve publik nga komuna e Deçanit. Shembull mund të merret firma “Agimi De” e cila menaxhohet nga vëllai i kryetarit të komunës. Kjo firmë në vazhdimësi përfiton tenderët e komunës për furnizimin e institucioneve komunale me material administrativ dhe po ashtu komuna kësaj firme i ka borxh për vitin 2010-2011 mbi 30.000 euro.

Opozita në kuvendin e Deçanit përgjithësisht është aktive dhe unike dhe kësaj propozimet e ekzekutivit nuk kalojnë lehtë në kuvendin komunal, edhe përkundër faktit që ekzekutivi ka shumicën absolute të vendeve në këtë kuvend. Janë disa raste kur me iniciativën dhe insistimin e partive opozitare, ekzekutivi ka ndërmarrë masa për sqarime shtesë apo formim të komisioneve të posaçme për verifikimin e ndonjë segmenti të caktuar.

Komuna e Deçanit ka gjithsejtë 11 drejtori. Me statutin e këtij institucioni thuhet se komuna ka vetëm 9 drejtori.<sup>4</sup> Në këtë rast është shpërfillur Statuti i Komunës, ngase kuvendi komunal me rastin e marrjes së vendimit për rritjen e numrit të drejtorive, është dashur të marrë vendim edhe për ndryshimin e statutit. Një nga arsyet se përse nuk është bërë kjo mund të jetë se për ndryshimin e statutit nevojiten 2/3 e votave të Kuvendit, vota këto që ekzekutivi nuk i ka në kuvend.

Instituti GAP ka evidentuar dhe vlerësuar ecurinë e përgjithshme të zhvillimeve në këtë komunë. Në këtë raport, janë evidentuar problemet, mangësitë dhe vështirësitë e komunës së Deçanit, veçmas mes periudhës janar 2010 – qershor 2012, në sferat e investimeve kapitale, mënyrës së shfrytëzimit dhe shpenzimit të parasë publike, shkallës së transparencës, prokurimit publik, funksionimit të administratës dhe po ashtu janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga Kryetari i Komunës gjatë fushatës zgjedhore 2009 dhe ecuria e deritanishme e realizimit të tyre.

<sup>3</sup> [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Decan\\_2011\\_ALB\\_434669.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Decan_2011_ALB_434669.pdf)

<sup>4</sup> Statuti i Komunës së Deçanit neni 63 dhe neni 63.3. <http://kk.rks-gov.net/decan/getattachment/Home/Statuti-i-Komunes-2010.pdf.aspx>

## 1. Problemet në Komunën e Deçanit

Prerja e pakontrolluar dhe masive e pyjeve, mungesa e ujit të pijes, ekzistimi i dhjetëra deponive të egra mbeturinash, mungesa e përfshirjes së tërë territorit të Deçanit në rrjetin e kanalizimit, mos mirëmbajtja e Shtëpisë së Kulturës, mos menaxhimi efikas i zonës së quajtur “Podi i gështenjave”, mos asfaltimi i rrugës në relacionin Deçan-Plavë, llogariten si probleme madhore për komunën e Deçanit.

Rajoni i Deçanit njihet për male të shumta dhe të larta. Që nga periudha e pas luftës, malet e këtij rajoni i janë ekspozuar prerjeve të pakontrolluara dhe masive, faktor ky që ka ndikuar e po ndikon në dëmtimin sistematik të pyjeve dhe në tjetërsimin gradual të ekosistemit. Autoritetet lokale janë ndjerë të pafuqishme për t’ia ndalur hovin kësaj dukurie negative. Ka indikacione të shumta që aludojnë për një përzierje interesash mes organeve komunale, atyre të rendit dhe prerëseve të pyjeve. Kjo dukuri, ndonëse e sensibilizuar si tejet e dëmshme dhe me shtrirje të gjerë, nuk është vënë asnjëherë nën kontrollë. Udhëheqësit komunal kanë synuar që përmes tenderëve publik të rregullojnë dhe menaxhojnë problematikën e prerjes së pyjeve, por kjo masë nuk ka ndikuar as në zvogëlimin dhe as në kontrollimin e kësaj dukurie. Kanë qenë të shpeshta rastet edhe të prerjes së pishave dhe drunjve të gështenjave dhe e gjithë kjo nuk është përcjellë aktivisht nga ana e autoriteteve.

Si problem i dytë madhor për komunën e Deçanit, viteve të fundit ka rezultuar edhe mungesa e ujit të pijes si për qytetin e Deçanit ashtu edhe për fshatrat e kësaj komune. Deçani karakterizohet me rrjedha dhe burime të shumta të ujit. Nga kjo komunë janë ujitur pjesa dërmuese e arave të rajonit të Dukagjinit. Gjatë kësaj vere, reduktimet e ujit në zonat urbane kanë shkuar deri në 15 orë brenda një dite. Gjendje edhe më e keqe ka mbizotëruar në fshatra, ku për ditë të tëra ka munguar uji i pijes. Autoritetet komunale e kanë arsyetuar këtë gjendje më rritjen e nevojave për ujë dhe me kyçje të shumta ilegale në rrjetin e ujësjellësit. Por, krahas rritjes së nevojave, institucionet kompetente do të duheshin të hartonin plane dhe të bënin investime në gjenerimin e burimeve të ujit. Në të njëjtën kohë kyçjet ilegale do të mund të parandaloheshin apo minimizoheshin me masa më rigorozë të monitorimit dhe ndëshkimit ndaj subjekteve që nuk i përfillin procedurat e parapara për kyçje në rrjetin e ujësjellësit.

Në territorin e komunës së Deçanit mund të hasen dhjetëra deponi të egra mbeturinash. Pothuajse në të gjitha fshatrat e kësaj komune ndodhen deri në dy deponi të tilla. Raportet e prezantuara në media flasin së në gjithë territorin e komunës së Deçanit gjenden deri në 70 deponi. Autoritetet kanë ndërmarrë disa herë radhazi veprime në largimin e tyre, por gjendja nuk ka ndryshuar. Pas pak kohësh deponitë e larguara janë krijuar sërish. Niveli i pastërtisë nuk është i kënaqshëm as në vetë qytetin e Deçanit. Së fundi, USAID ka financuar vendosjen e kontejnerëve të mbeturinave në qytet si fazë e parë, ndërsa në fazën e dytë e cila parashihet të përmbyllet deri në fund të këtij viti, kontejnerë të tillë priten të vendosen edhe në periferi të qytetit. Një faktor tjetër që ka

ndikuar në keqësimin e gjendjes së pastërtisë në qytet vlerësohet të jetë edhe mos pagesa me rregull e punëtorëve të kompanisë publiko - komunale "Higjiena". Punëtorët e kësaj kompanie deri në muajin e shtatë të këtij viti kanë tërhequr vetëm katër paga.

Komuna e Deçanit ka arritur që gjatë dy viteve të kaluara të zgjidhë problemin e mungesës së kanalizimeve në qytet. Por, ky problem ka mbetur i pazgjidhur për fshatrat e kësaj ane. Një pjesë e madhe e kanalizimeve derdhen në lumin e vetëm të Deçanit i njohur si Bistrica apo Lumëbardhi.

Gjendja aktuale e Shtëpisë së Kulturës në Deçan paraqet imazh të keq për qytetin. Gjendja e këtij pallati është e rëndë dhe kundërmon erë të padurueshme. Një pjesë e tij shfrytëzohet për çështje komerciale e private. Disa herë radhazi që nga pas lufta, pallatit i është ndërruar kulmi, por në vazhdimësi gjatë të reshurave, uji ka depërtuar në hapësirat e brendshme të këtij pallati. Mbi 80% e hapësirës është e papërdorshme. Një pjesë e pallatit të kulturës i është lëshuar vëllait të kryetarit të Komunës, Fahri Selmanajt. Ai është pronar i librarisë "Agimi De". Gjatë vitit 2011 - firma "Agimi De" - ka riparuar hapësirën ku ushtron veprimtarinë në pallatin e Kulturës dhe po ashtu ka hapur një hyrje të re në pallat për të shkuar më lehtë te firma në fjalë. Një kënd i pallatit shfrytëzohet gjithashtu për diskotekë dhe lojëra të fatit.

Komuna e Deçanit ka paraparë që zonën që njihet si "Podi i gështenjave" ta shndërrojë në deponi mbeturinash. Kjo nismë e komunës, në rast të implementimit në praktikë, do të dëmtojë dhe zhvlerësojë dhjetëra hektarë hardhishte gështenjash, nga të cilat një pjesë e konsiderueshme e familjeve të deçanasve i sigurojnë të ardhurat.

Problem tjetër i shfaqur viteve të fundit në komunën e Deçanit ka rezultuar të jetë pamundësia e autoriteteve lokale për të zgjeruar dhe asfaltuar rrugën në relacionin Deçan - Plavë, ngase kjo nuk lejohet nga përgjegjësit e manastirit të Deçanit të cilët aludojnë që projekti u cenon atyre sigurinë dhe pronësinë. Manastiri i Deçanit është një nga objektet më të vjetra fetare në këtë komunë. Sipas Pakos së Ahtisaarit, Manastiri i Deçanit është objekt i trashëgimisë fetare serbe dhe i ndahet një zonë prej 80 hektarësh e cila konsiderohet si zonë e veçantë. Banorët që kanë pronat e tyre në këtë pjesë kanë kufizime specifike në rast që dëshirojnë t'i punojnë tokat e tyre.

## 2. Performanca buxhetore e Komunës së Deçanit

Komuna e Deçanit ka arritur progres të lehtë në rritjen e të hyrave komunale, por sipas Raportit të Auditorit të Përgjithshëm, autoritetet lokale në Deçan i kanë shpërfillur disa procedurat të cilat në mënyrë esenciale do të ndikonin në rritjen e të hyrave komunale. Procedurat të cilat janë shpërfillur sipas Auditorit lidhen me mos posedimin nga ana e Komunës së Deçanit të listës së fundit të bizneseve aktive dhe po ashtu komuna nuk ka bërë ri-regjistrimin e zonave për të modifikuar koston e të hyrave nga tatimi në pronë.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale 2009-2011

Viti	Shuma (Euro)
2009	427.000
2010	422.000
2011	573.000

Nga tabela e mësipërme vërehet se dallimi në mes të hyrave nga viti 2011 krahasuar me atë 2010 dallon për 151.000 euro më shumë në vitin e fundit.

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Deçanit për vitin 2011

Kategoria	Shuma (Euro)
Investime kapitale	1.827.541
Mallra dhe shërbime	287.859
Subvencione	10.314
Shpenzime komunale	119.889
Paga dhe mëditje	3.738.041
<b>Totali</b>	<b>5.983.644</b>

Komuna e Deçanit ka një trend relativisht të lartë të shpenzimit të parasë publike në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbime. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në këtë kategori (mallëra dhe shërbime) komuna e Deçanit gjatë një viti ka në dispozicion 287.859 euro, ndërsa për 2012 janë të parapara mbi 300.000 në këtë linjë të buxhetit.

Tabela nr.3: Pasqyrimi i shpenzimeve të derivateve sipas drejtorive dhe sektorëve tjerë në Komunën e Deçanit gjatë vitit 2011.<sup>5</sup>

Kategoria	Shuma (Euro)
Zyra e Kryetarit	35.229
Drejtoria e Administratës	7.502

<sup>5</sup> Komuna e Deçanit. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.

Drejtoria e Shërbimeve Publike	5.854
Drejtoria e Kulturës	3.881
Drejtoria për buxhet dhe Financa	3.263
Drejtoria e Inspektionit	550
Drejtoria e Urbanizimit	1.314
Zyra e Prokurimit	390
Drejtoria e Bujqësisë	1.112
Drejtoria e Ekonomisë	240
Drejtoria e Gjeodezisë	00
Drejtoria e Arsimit	17.533
Drejtoria e Shëndetësisë <sup>6</sup>	31.583
<b>Gjithsejtë</b>	<b>108.451</b>

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se drejtoritë që është dashur të dalin më së shumti në terren (Inspektioni dhe Gjeodezia) kanë shpenzuar më së paku për karburante.

Tabela nr.4: Pasqyrimi i shpenzimeve në dreka dhe darka zyrtare sipas drejtorive dhe sektorëve tjerë në Komunën e Deçanit gjatë vitit 2011.<sup>7</sup>

<b>Kategoria</b>	<b>Shuma (Euro)</b>
Zyra e Kryetarit	5.632
Drejtoria e Administratës	1.694
Drejtoria e Shërbimeve Publike	161
Drejtoria e Kulturës	00
Zyra e Prokurimit	998
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1.389
Drejtoria e Inspektionit	1.937
Drejtoria e Urbanizimit	420
Zyra e Komuniteteve	510
Drejtoria e Bujqësisë	2.076
Drejtoria e Ekonomisë	224
Drejtoria e Gjeodezisë	00
Drejtoria e Arsimit	2.920
Drejtoria e Shëndetësisë	250
<b>Gjithsejtë</b>	<b>18.211</b>

Në vitin 2011, Drejtoria e Inspektionit ka shpenzuar 1.937 euro për dreka e darka zyrtare. Nuk është e qartë se pse një drejtori që i mbulon sferën e ndërtimeve të shtrojë

<sup>6</sup> Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Deçanit ka shpenzuar për gjenerator 16.461, ndërsa për vetura 15.122 euro gjatë vitit 2011.

<sup>7</sup> Komuna e Deçanit. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.



darka e dreka zyrtare. Po ashtu edhe zyra e prokurimit në komunë të Deçanit ka shpenzuar 998 euro për dreka zyrtare. Edhe në këtë rast nuk është e qartë se pse një dikaster që i mbulon tenderët dhe kontratat e komunës me operatorët privat të shtronte drekë zyrtare.

Tabela nr.5: Pasqyrimi i shpenzimeve në riparimin e automjeteve zyrtare sipas sektorëve që menaxhojnë me automjete në Komunën e Deçanit gjatë vitit 2011.<sup>8</sup>

Kategoria	Shuma (Euro)
Zyra e Kryetarit	12.015
Drejtoria e Administratës	1.215
Drejtoria e Shëndetësisë	9.393
<b>Gjithsejtë</b>	<b>22.623</b>

### 3. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Deçanit gjatë dy viteve të kaluara (2010-2011) janë fokusuar kryesisht në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, instalimit dhe shtrirjes së rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Deçanit për investime kapitale gjatë një viti është afro 1.9 milion euro.

Tabela nr.6: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Deçanit të realizuara gjatë vitit 2011

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Vlera (Euro)
Punimi i kanalizimit të ujrave të zeza të Deçanit 'Faza e tretë'	298.822,27
Asfaltimi i rrugës së Papiqit	158.668,50
Punimi i stadiumit të futbollit në Deçan 'Faza e dytë'	498.812,39
Rregullimi i ujësjellësit për pesë fshatra të regjionit të Vokshit	47.521
Asfaltimi i Rrugës në lagjen "Zeqaj" në Strelc	24.155
Asfaltimi i Rrugës në Lumbardh	206.623,88
Punimi i Kanalit të Gerhotit	76.392,98
Punimi me kubëza të betonit i trotuarit Strelc-Lëbushë	28.936,81
Asfaltimi i rrugës "Haki Povataj" në Deçan	183.577,64
Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Strelc	5.980

<sup>8</sup> Komuna e Deçanit. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.

Tabela nr. 6: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Deçanit të realizuara gjatë vitit 2010

<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011</b>	<b>Vlera (Euro) '000</b>
Punimi i stadiumit të futbollit në Deçan 'Faza e parë '	99.547,50
Asfaltimi i rrugës Shaptej- Gramaqel	192.312,26
Asfaltimi i rrugës Osmonaj në Isniq	296.475,12
Asfaltimi i rrugës në relacionin Polana-Drenoc-Prejlep	274.346,58
Punimi i sistemit të ujësjellësit në Isniq	257.129,00
Rekonstruktimi i rrugës "Sali Çeku" në Deçan	108.394,20
Asfaltimi i rrugës Beleg -Kodralli	41.694,40
Asfaltimi i rrugës Deçan - Hulaj	194.849,44
Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Carrabreg i Ulët	7.892
Asfaltimi i rrugës Deçan – Carrabreg i Epërm	111.230,30
Punimi me kubëza të betonit i rrugës Curraj në Strellc	48.174,24

Qyteti i Deçanit edhe përkundër disa investimeve publike karakterizohet me një pamje të jo të rregullt ndërtimesh, me mungesë kontejnerësh mbeturinash, si dhe pa të vendeve të gjelbëruara dhe rekreative. Rrugët janë përgjithësisht të ngushta dhe trotualet e dëmtuara. Disa investime komunale nuk e kanë pasur efektin e synuar. Në oborrin e komunës së Deçanit gjatë vitit 2011 është ndërtuar nga vetë komuna një pompë e benzinës për qëllime të furnizimit me naftë të veturave zyrtare. Asnjëherë nga askush kjo pompë nuk është shfrytëzuar dhe asnjëherë ekzekutivi i komunës nuk ka dhënë përgjigje zyrtare se pse është ndërtuar ajo pompë e benzinës në oborrin e komunës. Ngjashëm ka vepruar komuna edhe me ndërtimin e një tribune në oborrin e komunës për zhvillimin e koncerteve dhe manifestimeve tjera. Asnjëherë kjo tribunë nuk është shfrytëzuar.

#### **4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011**

Për dy vitet 2010 dhe 2011, komuna e Deçanit nëpërmjet procedurave prokurimit publik ka lidhur të 254 kontrata në vlerë të përgjithshme mbi 8.4 milionë euro. Organi i prokurimit në komunë të Deçanit funksionin në nivel të Zyrës së Prokurimit dhe ka gjithsej tre të punësuar. Disa investime janë mbuluar financiarisht nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtar, ndërsa procedurat e prokurimit janë përmbushur nga ana e komunës së Deçanit.

Tabela nr.7: Kontratat e Prokurimit në Komunën Deçanit

<b>Viti</b>	<b>Nr. i kontratave</b>	<b>Vlera e kontratave (Euro)</b>
<b>2010</b>	135	4.648.918,70
<b>2011</b>	119	3.776.442,15
<b>Totali</b>	<b>254</b>	<b>8.425.360,85</b>

## 5. Administrata e Komunës së Deçanit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën e komunës së Deçanit është 119 persona duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Së bashku me këta dy sektorë numri i përgjithshëm i të punësuarve në Deçan është gjithsejtë 829 të punësuar (në komunë, arsim dhe shëndetësi).

Tabela nr.8: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Deçanit

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	11
Drejtoria e Administratës	29
Drejtoria e Financave	13
Drejtoria e Urbanizimit	6
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim rural	3
Spektori i Arsimit	581
Drejtoria e Arsimit	6
Spektori i Shëndetësisë	119
Drejtoria e Shërbimeve publike/Zjarrfikës	18
Zyra për komunitete	3
Drejtoria për Kulturë-Rini dhe Sport	13
Drejtoria e Shëndetësisë	1
Drejtoria e Inspektionit	6
Drejtoria e Gjeodezisë	7
Qendra për Punë Sociale	10
Drejtoria për Ekonomi dhe zhvillim	3
<b>Gjithsejtë</b>	<b>829</b>

Nga tabela e mësipërme vërehet një fokusim i të punësuarve në disa sektorë dhe numër jo aq i madh në ata sektorë ku llogaritet të ketë një shumëllojshmëri më të madhe të punëve. Kësisoj, rezulton se Drejtoria e Kulturës ka gjithsejtë 13 të punësuar, përderisa Drejtoria e Shëndetësisë ka 1 të punësuar, përkatësisht vetëm drejtori i Drejtorisë. Ndërsa, Zyra për Komunitete ka 3 të punësuar, numër ky i ngjashëm me numrin e të punësuarve në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural.

Tabela nr.9: Të punësuarit në komunë nga këndvështrimi gjinor

Numri	Femra	Meshkuj
119	24	95

Nga gjithsejtë 11 Drejtori sa ka komuna e Deçanit, vetëm Drejtoria e Inspektionit udhëhiqet nga një femër. Përfaqësimi i femrës në pozitat publike në Komunën e Deçanit vazhdon të mbetet tejet i ulët dhe nga tabela e mësipërme vërehet një përfaqësim i vogël i femrave në pozitat brenda dikastereve të komunës në Deçan. Përfaqësim i vogël i femrave haset edhe në sektorët e arsimit dhe atë të shëndetësisë.

Tabela nr.10: Ndarja e të punësuarve në femra dhe meshkuj sipas sektorëve në Komunën e Deçanit

Sektorët	Femra	Meshkuj
Zyra e Kryetarit	1	10
Drejtorja e Administratës	8	21
Drejtorja e Financave	5	8
Drejtorja e Urbanizimit	3	3
Drejtorja e Bujqësisë	0	3
Drejtorja e Arsimit	1	5
Drejtorja e Shërbimeve publike/ Zjarrfikës	0	18
Zyra për komunitete	0	3
Drejtorja për Kulturë	3	10
Drejtorja e Shëndetësisë	0	1
Drejtorja e Inspektionit	2	4
Drejtorja e Gjeodezisë	1	6
Drejtorja për Ekonomi dhe zhvillim	0	3
<b>Gjithsejtë</b>	<b>24</b>	<b>95</b>

## 6. Arsimi në Komunën e Deçanit

Në Komunën e Deçanit funksionojnë gjithsejtë 21 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme.

Tabela nr.11: Numri i përgjithshëm i nxënësve në 21 shkollat fillore në Komunën e Deçanit:

Numri i nxënësve	Femra	Meshkuj
5.236	2.546	2.690

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në 21 shkollat fillore të Deçanit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	151	5
Meshkuj	218	81
<b>Gjithsejtë</b>	<b>369</b>	<b>86</b>

Në Komunën e Deçanit ekzistojnë tri shkolla të mesme të profilit gjimnaz dhe ekonomi.

Tabela nr.13: Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e mesme në Komunën e Deçanit:

Numri i nxënësve	Femra	Meshkuj
<b>2.115</b>	838	1277

Tabela nr.14: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në shkollat e mesme të Deçanit

Gjinia	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	26	1
Meshkuj	76	23
<b>Gjithsejtë</b>	<b>102</b>	<b>24</b>

Tabela nr.15: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 21 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme në Komunën e Deçanit

Kategoria	Mësimdhënës	Nxënës	Stafi ndihmës
Femra	177	3.384	6
Meshkuj	294	3.967	104
<b>Gjithsejtë</b>	<b>471</b>	<b>7.351</b>	<b>110</b>

Investimet në sferën e arsimit në komunën e Deçanit kanë qenë përgjithësisht sipërfaqësore dhe nuk është shënuar ndonjë progres i madh në përmirësimin e kushteve infrastrukturore krahasuar me kohën e para zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Nuk ka pasur nisma për ndërtimin e shkollave të reja apo për renovimin e brendshëm dhe të jashtëm të shkollave ekzistuese. Investimet më të mëdha të vërejtura në këtë drejtim janë fokusuar në mirëmbajtjen e objekteve të shkollave, në sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje, në riparimin e dymëve, dritareve dhe pajisjeve tjera si dhe në ndërrimin e kohëpaskohshëm të bankave dhe karrigeve. Karakteristikë në këtë komunë në sferën e arsimit është edhe mungesa e investimeve nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ku gjatë dy viteve të kaluara nuk është hasur ndonjë projekt i mbështetur financiarisht nga ana e kësaj ministrie.

Tabela nr.16: Disa nga investimet gjatë 2010-2011 në infrastrukturën e shkollave të Deçanit

Investimet	Shuma (Euro) '000
Punimi i sallës së sportit në shkollën fillore "Lidhja e Prizrenit" në Deçan (dy faza)	46.622,36
Renovimi i Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri" në Deçan	87.321,32
Rregullimi i terreneve sportive në tetë shkolla fillore në Komunën e Deçanit	110.836,20

## 7. Shëndetësia në Komunën e Deçanit

Në Komunën e Deçanit funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe gjashtë njësi shëndetësore apo ambulanca. QKMF gjendet në qendër të qytetit, ndërsa QMF-të janë të shpërndara nëpër fshatra. Njëra gjendet në fshatin Isniq, një tjetër në fshatin Strellc i Epërm dhe e fundit në fshatin Irzniq. Po ashtu edhe njësitë shëndetësore janë të shpërndara në fshatrat e kësaj ane dhe gjenden në Prapaqan, Pobergjë, Prelep, Lumbardh, Ratish dhe në fshatin Gramaqel.

Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në komunën e Deçanit është 119 të punësuar. Pjesa më e madhe prej tyre janë të punësuar në QKMF-në "Adem Ukëhaxhaj".

Tabela nr.17: Numri dhe pozitat e të punësuarve në QKMF në Deçan:

Stafi i QKMF	Numri
Spektori i administratës	7
Spektori i mjekësisë familjare	35
Spektori i vaksinimit	3
Spektori stomatologjisë	10
Spektori i pediatriisë	12
Spektori i urologjisë	2
Spektori i oftalmologjisë	2
Spektorii dermatologjisë	2
Spektori i internos	3
Spektori i gjinekologjisë	8
Shërbimi i laboratorit	4
Barnatorja e QKMF	2
Ndihma e shpejtë	3
Shërbimi i pastërtisë	4
<b>Gjithsejtë</b>	<b>97</b>

Tabela nr.18: Shpërndarja e të punësuarve në tri QMF dhe në gjashtë njësi shëndetësore në Deçan

Lokacioni	Numri
QMF - Isniq	6
QMF - Irzniq	2
QMF - Strellc i Epërm	5
Ambulanca në Propoqan	1
Ambulanca në Pobergjë	3
Ambulanca në Prelep	1
Ambulanca në Lumbardhë	1
Ambulanca në Ratisht	1
Ambulanca në Gramaqel	2
<b>Gjithsejtë</b>	<b>22</b>

Gjendja e përgjithshme e shëndetësisë në Deçan karakterizohet me mungesa të përditshme të mjeteve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve për pacientët. Gjendje më e mirë në këtë drejtim paraqitet në QKMF, por edhe nga atje janë të shumta rastet kur pacientet obligohen t'i blejnë mjetet esenciale me kusht të ofrimit të shërbimeve.

## 8. Transparenca

Zyra për Informim në Komunën e Deçanit funksionon brenda Drejtorisë së Administratës dhe ka një të punësuar. Deçani nuk ka ndonjë medium të fuqishëm lokal, përjashtimisht një radio e cila nuk ka kapacitete profesionale dhe financiare për të bërë pasqyrime gjithëpërfshirëse. Kjo komunë mbulohet rregullisht nga mediumet e shkruara të cilat kanë të angazhuar korrespondentë nga ky lokalitet.

Televizioni nga Gjakova "Syri Vizion" (i cili mbulon rrafshin e Dukagjinit), ka lidhur kontratë me komunën për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të Kuvendit Komunal të Deçanit. Por, asnjëherë nuk janë transmetuar seancat e këtij kuvendi në këtë televizion, përveç dhënies së një lajmi të shkurtër për mbajtjen e tyre. Përgjithësisht dhe gjerësisht nga ky televizion mbulohen dhe transmetohen aktivitetet dhe agjenda e kryetarit të Komunës. Me datë 24.04.2012 është lidhur kontrata e re mes komunës së Deçanit dhe televizionit "Syri Vizion" në kohëzgjatje një vjeçare në vlerë prej 1.200 euro në muaj.

Opozita në Kuvendin Komunal të Deçanit më datë 12.01.2012 ka braktisur seancën e kuvendit në shenjë të kundërshtimit ndaj prezencës së televizionit "Syri Vizion" me arsyetimin së transmetimet e këtij televizioni për zhvillimet në Deçan janë të njëanshme

dhe në favor të ekzekutivit.<sup>9</sup> Në listën e pagave të personelit haset se në Zyrën e Informimit në komunë të Deçanit e punësuar është Yllarta Thaçi, e cila njëkohësisht mban edhe pozitën e gazetares në televizionin “Syri Vizion” Të gjitha reportazhet që i dërgohen këtij televizioni për transmetim nga Komuna e Deçanit përgatiten nga znj. Thaçi.<sup>10</sup>

Komuna e Deçanit posedon edhe ueb faqen zyrtare, por sasia e informatave që janë postuar janë më të paktat në mesin e ueb faqeve tjera të komunave të vendit. Mungojnë raportet e punës, raportet e kryetarit, buxheti i planifikuar dhe raportet për shpenzimet, procesverbalet nga kuvendit komunal dhe mungojnë rregulloret bazike dhe vendimet tjera më interes për komunën dhe opinionin në përgjithësi. Kjo do të duhet adresuar dhe ndryshuar urgjentisht nga ana e përgjegjësve të komunës së Deçanit.

Tabela nr.19: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes të Komunës së Deçanit  
<http://kk.rks-gov.net/decan/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizmi, Kadastri dhe Mjedisi	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit					√				
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm					x				
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x			x			x		
Rregulloret Komunale					x				

<sup>9</sup> [http://www.syri-vizion.tv/index.php?option=com\\_content&view=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vizion&catid=3:lokale&Itemid=21](http://www.syri-vizion.tv/index.php?option=com_content&view=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vizion&catid=3:lokale&Itemid=21)

<sup>10</sup> [http://www.syri-vizion.tv/index.php?option=com\\_content&view=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vizion&catid=3:lokale&Itemid=21](http://www.syri-vizion.tv/index.php?option=com_content&view=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vizion&catid=3:lokale&Itemid=21)



Vendimet e Kuvendit Komunal	x		x		x			
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x							
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√							

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar në ueb-faqe

## 9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Rasim Selmanaj, para elektoratit të tij ka prezantuar 95 premtime për sfera të ndryshme. Pas numërimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në vitin 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës duke i'a përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna, dhe njëkohësisht duke kërkuar realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë pasqyron progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 35 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP, del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën së Deçanit, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 10 premtime janë përmbushur, 21 premtime nuk janë realizuar, ndërsa për 4 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por akoma nuk mund të vlerësohen të përmbyllura.

Premtimet	Realizueshmëria
Angazhimin e rreth 500 punëtorëve sezonal dhe dhjetëra punëtorëve të rregullt në mbrojtje dhe kultivim të pyjeve	Premtim i papërmbushur. Nuk ka pasur as nisma të kësaj natyre.
Dyfishimin e rojeve në pyll	Premtim i papërmbushur. E gjithë Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural i ka gjithsejtë tre të punësuar.
Formimin e drejtorisë së pyjeve	Drejtori të pyjeve nuk ka; sektori për pyje funksionon brenda Drejtorisë së Bujqësisë.
Investimet kapitale në vlerë rreth 2 milion euro dhe rritja e të hyrave	Premtim i përmbushur. Vlera e investimeve kapitale në vit në Deçan i ofrohet 2 milionë eurove. Gjithashtu edhe shkalla e të hyrave ka shënuar rritje solide.
Investime për të zgjidhur problemin nga mungesa e ujit të pijes	Premtim i papërmbushur. Deçani veçmas në dy vitet e fundit ka probleme serioze të ujit të pijes, ndonëse ka pasur nisma dhe investime nga komuna në këtë sferë, siç është shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Strellc i epërm dhe Strellc i poshtëm.

Investimet në rrugë, trotuare dhe ndriçim publik	Premtim gjysmë i përmbushur. Vërejtjet më evidente janë të mungesa e ndriçimit publik dhe trotuareve.
Riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive dhe sociale	Premtim gjysmë i përmbushur. Disa shkolla dhe qendra shëndetësore janë riparuar, por gjendja nuk ka ndryshuar rrënjësisht, ndërsa në sferën e kulturës, Pallati i Kulturës në Deçan paraqet imazh të keq për qytetin dhe në këtë drejtim komuna nuk ka bërë pothuajse asgjë.
Gjatë kohës së verës sportelet do të punojnë në komunë edhe jashtë orarit	Kjo është përmbushur.
Rishikimi i mundësisë për shkurtimin e afatit për rregullimin e dokumentacionit	Premtim i papërmbushur. Te rasti i letërnjoftimeve dhe pasaportave, komunat nuk kanë kompetenca në zgjatjen apo shkurtimin e afatit, ndërsa te rasti i certifikatave të lindjes dhe dokumentacionit tjetër përcjellës, kjo zakonisht rregullohet brenda një dite apo eventualisht brenda pak ditëve.
Kujdestari administrative për bashkëatdhetarët	Premtim i papërmbushur.
Takimi tradicional vjetor “Deçani dhe diaspora”	Premtim i përmbushur. Janë organizuar disa manifestime në Deçan që për qellim kanë pasur nderimin dhe vlerësimin e diasporës kosovare.
Sigurinë e plotë në investimet e diasporës qoftë në sektorin privat apo partneritet me komunën	Premtim i papërmbushur. Nuk ka pasur asnjë masë specifike nga komuna e cila do të ndikonte dhe lehtësonte këto lloj investimesh.
Ofrimin e pronave komunale me koncesion	Premtim i përmbushur, por komuna në këtë mes është treguar jo rigoroze në mbrojtjen e pronës publike. Shembull për këtë shërben rasti i Kompanisë “Gogaj Agi” i cili ka ndërtuar krejt afër komunës (10 metra larg) një ndërtesë të lartë, ndërsa parkingun e ndërtesës e ka bërë duke e rrënuar një objekt të vjetër komunal dhe duke e inkorporuar hapësirën publike për objektin e ndërtuar në partneritetin publiko privat.
Formimin e zyrës për këshillime juridike dhe ekonomike	Premtim i papërmbushur. Nuk ka pasur asnjë nismë të kësaj natyre

Krijimin e kushteve për funksionim normal të institucioneve të kulturës	Premtim i papërbushur. Shtëpia e Kulturës shfrytëzohet për diskotekë, loja të fatit dhe shitore komerciale, por jo edhe për aktivitete kulturore.
Organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe letrare	Premtim i papërbushur, përgjithësisht nuk vërehet ndonjë aktivitet i veçantë në këtë drejtim i ndërmarrë nga komuna e Deçanit.
Mbështetjen e OJQ-ve për të organizuar aktivitete kulturore	Komuna ndan para të konsiderueshme për subjektet e ndryshme, por nuk ka të dhëna se kujt i ndahen këto para dhe për çfarë arsye.
Kujdes të vazhdueshëm ndaj monumenteve kulturore	Premtim gjysmë i përbushur.
Saktësimin e formës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve sportive me Qeverinë, klubet dhe shoqërinë civile	Premtim i papërbushur. Nuk ka pasur asnjë nismë të kësaj natyre.
Ndërtimin e Sallës Sportive dhe Stadiumit të Qytetit	Premtim i përbushur. Është ndërtuar stadiumi i qytetit dhe disa salla të sportit.
Ndarjen e çmimit për sport “Ruzhdi Ramosaj”. Përkrahja e klubeve të sporteve dhe ndarja e buxhetit për to	Premtim i përbushur. Përgjithësisht ka pasur përkrahje financiare për klubet e sportit në Deçan, veçmas për futboll.
Organizimin e Kupës së Deçanit në gara me ski	Premtim i papërbushur.
Riaktivizimin e klubit të futbollit “Deçani” dhe “Besa”	Premtim gjysmë i përbushur. Klubi i futbollit “Deçani” është aktiv tani, ndërsa ajo “Besa” jo.
Ndarja e 30 mijë euro për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Isniq.	Premtim i papërbushur.
Sigurimin e bursave për nxënës dhe studentë të suksesshëm	Premtim i përbushur.
Punësimin sezonal për të rinjtë	Premtim i papërbushur. Asnjëherë nga komuna e Deçanit nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për punësim sezonal.
Organizimin e rrjetit vullnetar të të rinjve pranë Komunës	Premtim i papërbushur. Nuk ka pasur nisma të tilla.
Organizimin e debateve lidhur me temat rinore	Premtim i papërbushur. Nuk ka pasur nisma të tilla.
Subvencionimin e bujqësisë	Premtim i përbushur.

Përmirësimin e infrastrukturës rrugore	Premtim i përmbushur. Infrastruktura rrugore përgjithësisht është më e mirë krahasuar me kohën e parazgjedhjeve të vitit 2009.
Identifikimin e bizneseve joformale dhe legalizimi n e tyre	Premtim i papërmbushur. Sipas Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011, komuna e Deçanit nuk e ka listën përfundimtare nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ku do të duhet të saktësohej numri final i bizneseve aktive.
Hartimin e katalogut turistik komunal	Premtim i papërmbushur.
Ndërtimin e fshatit turistik në fshatin e Bellës	Premtim i papërmbushur.
Ndërtimi i stazave të skijimit në bjeshkët e Belgut	Premtim i papërmbushur
Ndërtimin e fshatit Olimpik në Bjeshkët e Belgut	Premtim i papërmbushur
Ndërtimin e teleferikut në Bjeshkët e Nemura	Premtim i papërmbushur

## 10. Burimet:

1. Komuna e Deçanit. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2011.
2. Komuna e Deçanit. Lista e të punësuarve në administratë.
3. Komuna e Deçanit. Lista e të punësuarve në shëndetësi.
4. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011. [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Decan\\_2011\\_ALB\\_434669.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Decan_2011_ALB_434669.pdf)
5. Komuna e Deçanit. Statuti i Komunës së Deçanit. <http://kk.rks-gov.net/decan/getattachment/Home/Statuti-i-Komunes-2010.pdf.aspx>.
6. Raporti Financiarë 2010 i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqendrore.aspx>
7. Ministria e Financave e Qeverisë së Kosovës. Raporti Financiarë 2011- Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqendrore.aspx>
8. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011-2012. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
9. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Deçanit - [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
10. Raportet vjetore 2010 -2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90)
11. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Deçanit. <http://kk.rks-gov.net/decan/>
12. Njoftimi nga Televizioni “Syri Vizion” për bojkotin e Kuvendit Komunal të Deçanit. Burimi: [http://www.syri-vision.tv/index.php?option=com\\_content&vieë=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vision&catid=3:lokale&Itemid=21](http://www.syri-vision.tv/index.php?option=com_content&vieë=article&id=5801:opozita-ne-decan-braktis-seancen-shkas-tv-syri-vision&catid=3:lokale&Itemid=21)